



BULETINI I SEKTORIT FINANCIAR

Zyra e Kryeekonomistit

Numër 10

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

BULETINI I SEKTORIT FINANCIAR

BOTUES Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Zyra e Kryeekonomistit
33 Garibaldi, Prishtinë 10000
Tel: ++381 38 222 243
Faksi ++381 38 243 763

Faqja e internetit www.bqk-kos.org
Adresa elektronike economicanalysis@bqk-kos.org; statistics@bqk-kos.org

KRYEREDAKTOR Gani GËRGURI

REDAKTORË Arben MUSTAFA
Valentin TOÇI

Shtypur në "BLENDI" Prishtinë

Përdoruesit e të dhënavë nga ky botim luten që të citojnë burimin.

Shtypet në 100 kopje.

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
ATP	Agjensi i për Transferimin e Parasë
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
BQE	Banka Qendrore Evropiane
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IHH	Indeksi i Herfindahl-Hirschman
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KJP	Kreditë Jo Performuese
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësi ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekom i Kosovës
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

SIMBOLET KONVENCIONALE:

"—"	dukuria nuk ekziston
". "	dukuria ekziston, të dhënat nuk janë në dispozicion
" ... "	zero ose afér zeros
(e)	e vlerësuar
(p)	e projektuar
(r)	e reviduar

VËREJTJE:

Për shkak të rrumbullakimeve, shumat mund të mos janë plotësisht të sakta me pjesët e tyre.

Listë e Tabelave:

Tabela 1. Norma vjetore e rritjes së kredive dhe depozitave	3
Tabela 2. Numri i institucioneve financiare	5
Tabela 3. Rrjeti i sektorit bankar	10
Tabela 4. Struktura e aseteve, në përqindje.....	13
Tabela 5. Struktura e detyrimeve, në përqindje.....	17
Tabela 6. Bilanci i suksesit, në milionë euro.....	21
Tabela 7. Treguesit e efikasitetit të sektorit bankar	22

Listë e Figurave:

Figura 1. Norma Euribor	2
Figura 2. Struktura e aseteve të sistemit finanziar sipas sektorëve	6
Figura 3. Pasqyra e sektorit finanziar.....	7
Figura 4. Struktura e sistemit bankar sipas pronësisë	8
Figura 5. Struktura e tregut të sistemit bankar	9
Figura 6. Shkalla e ndërmjetësimit finanziar e sektorit bankar	11
Figura 7. Rritja vjetore e aseteve, kredive dhe depozitave.....	12
Figura 8. Struktura e kredive të ndërmarrjeve	14
Figura 9. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit	16
Figura 10. Struktura e depozitave sipas sektorëve.....	18
Figura 11. Faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e KMK-së	20
Figura 12. Normat e interesit	23
Figura 13. Kreditë jo përformuese dhe provisionet	25
Figura 14. Struktura e kredive sipas cilësisë	25
Figura 15. Treguesit e likuiditetit	26
Figura 16. Çmimi i aksioneve të TKPK-së dhe indeksi Dow Jones Industrial	28
Figura 17. Krahasimi i përformancës së TKPK-së me fondet pensionale nga disa vende të zgjedhura	29
Figura 18. Struktura e primeve të pranuara	30

Listë e Kutive:

Kutia 1. Zbërthimi i faktorëve që ndikojnë në Kthimin Mesatar në Kapital	19
Kutia 2. Norma e interesit	22
Kutia 3. Rreziku kreditor.....	26
Kutia 4. Rreziku i likuiditet	27

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
2. AMBIENTI FINANCIAR NDËRKOMBËTAR	2
3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË KOSOVË	4
4. SEKTORI FINANCIAR NË KOSOVË	5
4.1. Karakteristikat e përgjithshme	5
5. STRUKTURA E SEKTORIT BANKAR	7
5.1. Aktiviteti i ndërmjetësimit financiar	10
5.2. Bilanci i gjendjes i sektorit bankar	12
5.3. Performanca e sektorit bankar	18
6. FONDET PENSIONALE	27
7. KOMPANITË E SIGURIMEVE	29
8. INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE	30
9. NDIHMËSIT FINANCIAR	31

1. Përbledhje Ekzekutive

Kriza në ekonominë botërore vazhdoi edhe gjatë vitit 2009. Një numër i madh i vendeve, përfshirë vendet e eurozonës dhe të Evropës Jug-Lindore, shënuan ngadalësim të aktivitetit ekonomik dhe rënien ekonomike. Vështirësitë vazhduan të jenë prezentë edhe në sektorët financiar të këtyre vendeve. Megjithatë, qeveritë dhe bankat qendrore pothuaj në të gjitha vendet ishin aktive në ndërmarrjen e masave për sanimin e pasojave të krizës. Këto masa parandaluan thellimin e krizës në sektorin financiar dhe stimuluan aktivitetin e përgjithshëm ekonomik. Si rezultat, në tremujorin e tretë të këtij viti, vendet e eurozonës dolën nga recessioni duke shënuar normë pozitive të rritjes ekonomike.

Efektet e krizës globale u reflektojn edhe në ekonominë e Kosovës duke shkaktuar kështu një normë më të ulët të rritjes ekonomike krahasuar me vitet e kaluara. Megjithatë, ekonomia e Kosovës është një ndër ekonomitë e pakta në rajon që arri i këtë normë pozitive të rritjes gjatë këtij viti. Ndjekimi i krizës kryesisht u manifestua me një nivel më të ulët të dërgesave të emigrantëve, investimeve të huaja direkte dhe eksporteve të cilat ndikuani negativisht në konsum dhe investime. Kjo deri në një masë shkaktoi ngadalësim të kreditimit të ekonomisë nga sektori bankar në anticipim të një performance më të dobët të ekonomisë gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë, rritja e shpenzimeve qeveritare gjatë kësaj periudhe arri i absorboj në një masë efektet negative të krizës në ekonomi.


Për sa i përket sektorit financiar, deri në shtator 2009, efektet e krizës ishin mjaft të kufizuara dhe kryesisht u manifestuan me një ngadalësim të aktivitetit ndërmjetësues të sektorit bankar, gjë që kryesisht i atribuohet qasjes më konzervative të sektorit bankar ndaj zhvillimeve në sektorin real të ekonomisë dhe rivlerësimit të risqeve. Megjithatë, sektori bankar edhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të financojë ekonominë e vendit përmes kreditimit dhe ka vazhduar të ruaj qëndrueshmërinë. Gjatë vitit 2009, sistemi pensional, specifisht Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), realizoi norma pozitive të kthimit në investime, për dallim nga viti i kaluar kur turbulencat në tregjet financiare globale shkaktuan rënien të vlerës së investimeve. Zhvillime pozitive po ashtu u shënuan edhe në sektorët tjera financiar siç janë kompanitë e sigurimeve, institucionet mikro-financiare dhe ndihmësit finanziar të cilat vazhduan të zgjerojnë aktivitetin e tyre edhe gjatë kësaj periudhe.

2. Ambienti Financiar Ndërkombëtar¹

Kriza financiare e viteve të fundit solli ekonominë botërore në recesionin më të thellë që nga depresioni i viteve të tridhjeta. Gjatë vitit 2009, krahë rishikimit të politikave fiskale e rregulloreve financiare nga pothuaj të gjitha vendet e prekura nga kriza, efektet e krizës vazhduan të jenë prezente si në sektorin financiar ashtu edhe atë real të ekonomisë duke shtyrë shumë vende në recession, përfshirë vendet e eurozonës dhe të EJL-së.

Si përgjigje ndaj situatës së krijuar, qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve të prekura nga kriza ndërmorën masa të shumta si: zvogëlimi i normës bazë të interesit me qëllim të rritjes së likuiditetit në sektorin financiar, rritja e garacioneve shtetërore për depozita si dhe injektimi të fondeve publike për rikapitalizimin e bankave. Për shembull, Banka Qendrore Evropiane (BQE) zvogëloj disa herë normën bazë të interesit, duke e zvogëluar kështu deri në 1.0 përqind në pjesën e parë të vitit 2009 (nga 2.5 përqind sa ishte në vitin 2008). Kjo u reflektua edhe në normën interesit në tregun ndërbankar EURIBOR që shënoi rënien të vazhdueshme duke arritur nivelin prej 0.72 përqind në fund të vitit 2009, nga 2.86 përqind sa ishte në fillim të vitit (Figura 1).

Figura 1. Norma EURIBOR, mesatarja tremujore



Burimi: <http://www.euribor-rates.eu>

Këto masa u treguan efektive në stabilizimin e sektorit financiar, gjë që solli efekte pozitive edhe për sektorin real të ekonomisë. Në këtë kontekst, gjatë pjesës së dytë të vitit 2009 janë paraqitur shenjat e para të

¹ International Monetary Fund (2009): Regional Economic Outlook, European Central Bank (2009): Monthly Bulletin, European Commission (2009): EU Candidates and Pre-Accession Countries; Economic Quarterly, Business Monitor International (2009) Emerging Europe Monitor.

daljes nga recesioni të disa prej vendeve evropiane, si Gjermania dhe Franca, të cilat raportuan rritje pozitive të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) prej 0.3%. Pas përfundimit të tremujorit të tretë të vitit 2009, zyrtarisht u deklarua se eurozona doli nga recesioni duke regjistruar një rritje ekonomike prej 0.4%. Megjithatë, humbja e besimit në tregje po vazhdon të reflektojë negativisht në aktivitetin ekonomik. Me gjithë masat e ndërmarrë nga bankat qendrore për të rritur ofertën e mjeteve likuide në tregje, rritja e kredisë vazhdon të jetë e ulët duke u reflektuar në investime dhe aktivitetet ekonomik në përgjithësi. Përderisa ekonomia shënoi trende pozitive, norma e papunësisë në vendet e eurozonës vazhdon të rritet. Në fund të shtatorit 2009, norma e papunësisë në eurozonë arrii në 9.6%, nivel ky më i larti në dhjetëvjeçarin e fundit.

Efektet e krizës vazhduan të janë prezente edhe në vendet e EYL-së. Gjatë tremujorit të tretë 2009, pjesa më e madhe e vendeve të EYL-së raportuan norma negative të rritjes së PBB-së. Të vetmet vende në të cilat është vlerësuar se rritja ekonomike gjatë vitit 2009 do të jetë pozitive janë Shqipëria dhe Kosova. Zgjerimi i krizës drejtë vendeve të EYL-së kryesisht u manifestua me zvogëlim të eksporteve, investimeve të huaja direkte, dërgesave të emigrantëve si dhe ngadalësim të kredidhënies që shkaktuan rënien të kërkësës së përgjithshme. Si rezultat i zvogëlimit të eksporteve dhe zvogëlimit të të hyrave buxhetore, disa vende u detyruan të marrin ndihmë financiare nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Performanca më e dobët e ekonomive të vendeve të EYL-së gjatë vitit 2009 kushtëzoit politika kreditore më konzervative nga ana e bankave komerciale të cilat ngadalësuan kredi dhënien, me efekte zingjirore për aktivitetin ekonomik në këto vende. Në këtë kontekst, në disa vende të EYL-së u shënuan norma negative të rritjes së kredisë (Tabela 1). Gjatë kësaj periudhe, evidente ishin edhe zhvillimet negative në cilësinë e portofoleve kreditore të bankave komerciale në këto vende ku u regjistrua rritje e kredive jo-performuese.

Tabela 1. Norma vjetore e rritjes së kredive dhe depozitave, shtator 2009 (në përqindje)

	Bosnia dhe Hercegovina	Kosova	Kroacia	Mali i Zi	Maqedonia	Serbia	Shqipëria
Kreditë	-1.4	13.2	-0.5	-9.9	14.5	20.3	12.1
Depozitat	-7.6	17.3	-0.3	-18.3	-0.3	16.5	58.0

Burimi: Komisioni Evropian dhe bankat qendrore përkatëse.

Zvogëlimi i të hyrave nga interesit në kredi dhe rritja e shpenzimeve për provizione ushtroi presion mbi të hyrat të sektorit bankar duke zvogëluar kështu profitabilitetin e këtij sektori. Efektet e krizës janë shfaqur edhe në tregun e depozitave, ku në disa prej vendeve të EYL-së janë shënuar norma negative të rritjes (Tabela 1). Sidoqoftë, në të gjitha vendet e EYL-së gjendja e sistemit finansiar vlerësohet të jetë stabile dhe nuk janë paraqitur zhvillime të cilat mund të kërcënojnë seriozisht qëndrueshmërinë e sistemit.

3. Zhvillimet Makroekonomike në Kosovë

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2009 ishte një ndër ekonomitë e pakta në rajon që vazhdoi të ketë normë pozitive të rritjes. Megjithatë, efektet e krizës globale u reflektuan edhe në Kosovë duke shkaktuar normë më të ulët të rritjes ekonomike e cila në vitin 2009 është vlerësuar të jetë 3.8 përqind, krahasuar me normën e rritjes prej 5.4 përqind në vitin 2008.² Efektet e krizës kryesisht u reflektuan në zvogëlimin e konsumit dhe investimeve të sektorit privat të cilat, në masën më të madhe, ishin pasojë e zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve, investimeve të huaja direkte si dhe shtrëngimit të kreditdhënieve nga sektori bankar. Dërgesat e emigrantëve, të cilat janë burim shumë i rëndësishëm i financimit për ekonominë e Kosovës, u ndikuan negativisht si pasojë e rritjes së normës së papunësisë në vendet ku janë të koncentruar emigrantët kosovarë. Në gjysmën e parë të vitit 2009, dërgesat e emigrantëve ishin për rreth 9 përqind më të ulëta se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke ndikuar veçanërisht mbi konsumin e ekonomive familjare.

Kriza globale ndikoi negativisht mundësitetë dhe planet investuese të shumë investitorëve të huaj potencial duke bërë që investimet e huaja direkte në Kosovë gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 të shënojnë një rënje vjetore prej rreth 25 përqind. Po ashtu, kreditë e sektorit bankar, të cilat paraqesin një burim shumë të rëndësishëm për financimin e bizneseve në Kosovë, në shtator 2008 shënuan një normë vjetore të rritjes prej 13.2 përqind. Kjo normë e rritjes është dukshëm më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur norma vjetore e rritjes së kredive ishte rreth 37 përqind. Kjo kryesisht për shkak të ndikimit të perceptimeve të bankave komerciale mbi aftësinë paguese të kredimarrësve si pasojë e paraqitjes së efekteve të krizës edhe në ekonominë e Kosovës dhe rivlerësimit të risqeve. Ngadalësimit të kreditdhënieve po ashtu mund t'i ketë kontribuar edhe norma më e ulët e rritjes së depozitave që në shtator 2009 ishte 17.2 përqind krahasuar me 32.1 përqind në shtator 2008. Kjo, deri në një masë, reflekton zvogëlimin e dërgesave të emigrantëve si dhe aftësinë më të dobët të ekonomisë në përgjithësi për të gjeneruar kursime nacionale.

Sidoqoftë, efektet negative të krizës për ekonominë, deri në një masë, u zbutën nga rritja e shpenzimeve qeveritare, të cilat në vitin 2009 shënuan një rritje vjetore prej rreth 20 përqind. Efekt pozitiv në normën reale të rritjes ekonomike ka pasur edhe norma më e ulët e rritjes së deficitit tregtar që është paraqitur edhe përkundër zvogëlimit të eksporteve, si dhe rënia e nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Deri në shtator të vitit 2009, eksportet e mallrave shënuan vlerën 108.8 milionë euro, një rënje vjetore prej 31.8 përqind. Në anën tjetër, importet shënuan vlerën 1.35 miliard euro, një rënje vjetore prej 1.6 përqind, që paraqet një ngadalësim të theksuar krahasuar me vitin e kaluar kur importet shënuan rritje vjetore prej 22.6 përqind. Rënia në nivelin e eksporteve dhe importeve pasqyron efektet e krizës ekonomike globale e cila ndikoi negativisht si kërkësën

² Vlerësimet e PBB-së janë vlerësime të Fondit Monitar Ndërkombëtar të paraqitura në *IMF Concluding Statement, Shtator 2009*.

e jashtme ashtu edhe kërkësën e brendshme. Recesioni që kaploj ekonominë globale kishte efekte negative për nivelin e çmimeve si rrjedhojë e zvogëlimit të kërkësës së përgjithshme. Si rezultat i mbështetjes së lartë të ekonomisë së Kosovës në importimin e mallrave, niveli i çmimeve në vend ka treguar ndjeshmëri të lartë ndaj zhvillimeve globale duke u karakterizuar me deflacion gjatë pjesës më të madhe të vitit 2009.

4. Sektori Financiar Në Kosovë

4.1. Karakteristikat e përgjithshme

Sektori financiar i Kosovës ka vazhduar funksionimin pa ndonjë tronditje edhe përkundër rrethanave jo të favorshme në sektorin financiar global. Kjo si rezultat i aktivitetit financiar bazik që ushtrojnë institucionet financiare që operojnë në Kosovë si dhe ekspozimit mjaft të ulët ndaj instrumenteve me risk më të lartë në nivel global. Efektet e krizës financiare në shkallë më të theksuar u reflektuan në sistemin pensional, konkretisht në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK), që gjatë vitit 2008 regjistroi rënie të vlerës së investimeve jashtë vendit. Sidoqoftë, performanca më e mirë e tregjeve financiare gjatë vitit 2009 u reflektua pozitivisht në kthimin e investimeve të TKPK-së. Një tjetër ndikim i krizës globale mund të konsiderohet ngadalësimi i aktivitetit ndërmjetësues financier të sektorit bankar kryesisht si përgjigje ndaj efekteve të krizës në sektorin real të ekonomisë së vendit.


Deri në shtator 2009, trendi i rritjes së sektorit financiar vazhdoi si për nga numri i institucioneve ashtu edhe për nga vlera e aseteve. Numri i institucioneve financiare në shtator 2009 ishte 69 krahasuar me 67 në shtator 2008 (Tabela 2). Në shtator 2009, vlera e aseteve të sektorit financiar arriti në 2.6 miliardë euro, që paraqet një rritje prej 16 përqind në krahasim më vitin 2008. Sidoqoftë, mund të vërehet një ngadalësim në shkallën e rritjes së aseteve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur norma vjetore e rritjes së aseteve ishte 25.1 përqind.

Tabela 2. Numri i institucioneve financiare

	2006	2007	2008	2009
Bankat komerciale	6	7	8	8
Kompanitë e sigurimeve	9	10	10	11
Fondet pensionale	7	2	2	2
Ndihmësit financier	18	30	29	28
Institucionet mikrofinanciare	20	16	16	19

Sektori bankar vazhdon të përfaqësojë shtyllën kryesore të sistemit finanziar, duke menaxhuar rrith 74.8 përqind të gjithsej aseteve. Krahasuar me vitin 2008, pjesëmarrja aseteve të sistemit bankar në gjithsej e asetet e sektorit finanziar ka pësuar një rënje e cila i atribuohet normës më të ulët të rritjes së kreditimit. Në anën tjetër, si rezultat i kthimeve pozitive në investimet e TKPK-së gjatë këtij viti, në shtator 2009 pjesëmarrja e aseteve të sistemit pensional arriti në 13.3 përqind të gjithsej aseteve të sektorit finanziar (nga 12.7 përqind sa ishte në shtator 2008). Institucionet mikro-financiare kanë rritur pjesëmarrjen në tregun e kredisë në Kosovë dhe si rezultat është rritur pjesëmarrja e tyre në gjithsej asetet e sektorit finanziar nga 4.5 përqind në shtator 2008 në 5.1 përqind në shtator 2009.

Figura 2. Struktura e aseteve të sistemit finanziar sipas sektorëve




Një pjesë e konsiderueshme e aseteve të sektorit finanziar, duke përfshirë asetet e BQK-së, vazhon të investohet në sektorin e jashtëm. Asetet e Jashtme Neto (AJN) të sektorit finanziar të Kosovës në shtator 2009 shënuan vlerën prej 1.72 miliardë euro (45.3 përqind të PBB-së për 2009), që është për 2.4 përqind më e ulët krahasuar me shtator 2008. Pjesën më të madhe të aseteve të sektorit finanziar të investuara në sektorin e jashtëm e përfaqësojnë asetet e BQK-së (65.6 përqind të gjithsej aseteve të investuara jashtë). Megjithatë, gjatë periudhës së fundit vërehet një ngadalësim i rritjes së investimeve të institacioneve financiare që operojnë në Kosovë (kryesisht të BQK-së) dhe kjo kryesisht si rezultat i rritjes së shpejtë të shpenzimeve qeveritare. Në anën tjetër, detyrimet e sektorit finanziar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm janë rritur krahasuar vitin e kaluar si rezultat i një shkalle më të lartë të shfrytëzimit të linjave kreditore nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë, duke shkaktuar kështu zvogëlim të aseteve të jashtme neto të sektorit finanziar.

Deri në shtator 2009, kërkësat e sektorit finanziar të Kosovës ndaj sektorit të jashtëm shënuan një rritje vjetore prej 5.1 përqind, e cila është më e ulët se sa norma vjetore e rritjes prej 13.3 përqind e shënuar në shtator 2008. Në strukturën e kërkësave të sektorit finanziar ndaj sektorit të jashtëm dominojnë investimet në

letra me vlerë që arritën 874 milionë euro ose 44.0 përqind të gjithsej kérkesave ndaj sektorit të jashtëm. Pjesëmarrja e këtyre instrumenteve shënoi një rritje të konsiderueshme (24.9pp) që kryesisht rezultoi nga zhvendosja e një pjese të investimeve të BQK-së nga depozitat në letra me vlerë të qeverive të ndryshme (si instrumente që bartin shkallë më ulët të rrezikut). Në shtator të vitit 2009, vlera e depozitave të sektorit finanziar të Kosovës në sektorin e jashtëm ishte 768 milion euro ose 38.6 përqind e totalit (65.8 përqind në shtator 2008).

Në shtator 2009 detyrimet e sektorit finanziar ndaj sektorit të jashtëm u dyfishuan krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar duke arritur vlerën prej 270 milionë euro. Struktura e tyre përbëhet kryesisht nga kreditë që kapin vlerën 151 milionë euro ose 55.8 përqind të gjithsej detyrimeve.

Figura 3. Pasqyra e sektorit finanziar




Sa i përket detyrimeve ndaj sektorit fiskal, të cilat kryesisht përbëhen nga depozitat e qeverisë në BQK, është observuar një rënie vjetore prej 12.8 përqind. Vlera e depozitave të qeverisë në BQK në shtator 2009 u zvogëlua në 868.7 milion euro (nga 996.7 milion euro në shtator 2008), që reflekton rritjen e shpenzimeve qeveritare në këtë periudhë. Në anën tjeter, sektori finanziar vazhdon të mos ketë kérkesa ndaj sektorit fiskal. Detyrimet e sektorit finanziar ndaj atij real nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të theksuar gjatë kësaj periudhe. Kérkesat vazhdojnë të dominohen nga kreditë e lëshuara nga bankat komerciale, ndërsa detyrimet ndaj sektorit real kryesisht përbëhen nga depozitat e këtij sektori në banka.

5. Struktura e sektorit bankar


Deri në shtator 2009, në sektorin bankar të Kosovës vazhduan të operojnë tetë banka komerciale. Struktura e sistemit bankar nuk pësoi ndonjë ndryshim në aspektin e pronësisë ku bankat me pronësi të huaj dominojë.

Nga tetë bankat komerciale që operojnë në Kosovë, gjashtë kanë pronësi dominante të huaj dhe dy banka kanë pronësi vendore. Pjesëmarrja e bankave me kapital të huaj në gjithsej asetet e sektorit bankar në shtator 2009 ishte 91.6 përqind, ndërsa bankat me kapital vendor menaxhojnë 8.4 përqind të gjithsej aseteve. Kapitali i huaj në sektorin bankar në Kosovë kryesisht ka origjinën nga vendet e Bashkimit Evropian, siç janë Gjermania, Austria dhe Sllovenia, ndërsa me një shkallë më të vogël merr pjesë edhe kapitali nga Turqia, Shqipëria dhe Serbia.

Figura 4. Struktura e sistemit bankar sipas pronësisë



Tregu i bankar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me shkallë të lartë koncentrimit, ku tri bankat më të mëdha menaxhojnë 82.4 përqind të gjithsej aseteve (e po ashtu edhe në tregun e kredive dhe depozitave) të sektorit bankar (shih Figurën 5). Nëse shkalla e koncentrimit krahasohet me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ku pjesëmarrja e tri bankave më të mëdha në totalin e aseteve ishte 86.9 përqind, vërehet rënie gjë që i atribuohet rritjes më të shpejtë të aseteve të bankave më të vogla. Kjo ka ndodhur për shkak se ngadalësimi i rritjes së aseteve, gjegjësisht kredive, ka qenë më i theksuar te bankat e mëdha. Rënia e vazhdueshme në shkallën e koncentrimit në sektorin bankar mund të observohet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH). Në shtator 2009, IHH për asete ishte 2,575 pikë që paraqet nivel më të ulët krahasuar me vitin e kaluar kur ky indeks kishte 2,885 pikë. Trend të ngjashëm ka ndjekur edhe tregu për kredi dhe depozita. Në fund të shtatorit 2009, IHH për tregun e kredive kishte 2,572 pikë (3,011 në shtator 2008), ndërsa për tregun e depozitave kishte 2,647 pikë (3,106 në shtator 2008). Nga kjo vërehet një rënie më e theksuar e shkallës së koncentrimit në tregun e kredive krahasuar me atë të depozitave, gjë që tregon për një depërtim më të lehtë të bankave të vogla në tregun e kredive. Kjo për arsy se bankat e mëdha kanë përparësi reputacionale ndaj bankave të vogla gjë që e bënë më të vështirë depërtimin e bankave të vogla në tregun e depozitave.

Figura 5. Struktura e tregut të sistemit bankar

Rritja e konkurrencës në sektorin bankar u manifestua edhe me zgjerimin e vazhdueshëm të rrjetit të bankave komerciale. Sidoqoftë, zgjerimi i rrjetit deri në shtator 2009 kishte një ritëm më të ngadalshëm krasuar me vitin paraprak, si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit të sektorit bankar. Numri i degëve dhe nëndegëve bankare në shtator 2009 arriti në 292 (nga 267 sa ishte në shtator 2008). Rritja e numrit të degëve është shoqëruar edhe me rritjen e numrit të të punësuarve në sistemin bankar. Gjithsej numri i të punësuarve në sistemin bankar është rritur nga 3,430 sa ishte në shtator 2008 në 3,664 në shtator 2009, që paraqet një ngritje prej 6.8 përqind. Megjithatë, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009 vërehet një stagnim pothuajse i plotë për sa i përket rritjes së numrit të të punësuarëve.


Tabela 3. Rrjeti i sektorit bankar

	shtator 2006	shtator 2007	shtator 2008	shtator 2009
Numri i degëve dhe nëndegëve	219	231	267	292
Numri i të punësuarëve	2,329	2,701	3,430	3,664
Numri i ATM-ve	116	155	275	293
Numri i POS-ve	1,767	2,554	3,723	4,900
Numri i llogarive E-banking	2,872	4,742	13,051	39,156


Rritja e konkurrencës dhe avancimi i vazhdueshëm i aktivitetit të sektorit bankar ka shtyre bankat të rrisin investimet të cilat kanë për qëllim lehtësimin e qasjes së klientëve në shërbimet bankare si dhe rritjen e efikasitetit të vetë institucioneve bankare. Në këtë kontekst, numri i bankomatëve në shtator 2009 arriti në 293 krahasuar me 275 në shtator 2008. Numri i Pikave të Shitjes ('POS-terminalët') është rritur për 31.6 përqind duke arritur në shtator 2009 në 4,900. Një produkt që dita e ditës është duke u përdorur më shumë janë llogari të elektronike bankare ('e-banking'), numri i të cilave ka arritur në 39,156. Zhvillimi i mëtejshëm i këtyre shërbimeve bankare do të kontribuojë në një kanalizim më të madh të pagesave përmes bankave komerciale duke zvogëluar kështu qarkullimin e parasë së gatshme në ekonominë e vendit.

5.1. Aktiviteti i ndërmjetësimit financiar

Asetet e sektorit bankar të Kosovës vazhduan trendin e rritjes edhe gjatë vitit 2009, por me një ritëm më të ngadalshëm. Vlera e gjithsej aseteve të sistemit bankar në shtator 2009 arriti në 2.1 miliard euro (apo 55 përqind e PBB-së së vitit 2009), që paraqet një rritje prej 18.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (Figura 6). Sidoqoftë, norma e rritjes së aseteve të sektorit bankar në shtator 2009 ishte për 12.8pp më e ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Figura 6. Shkalla e ndërmjetësimit financiar e sektorit bankar

Rritja e shkallës së ndërmjetësimit financiar gjatë vitit 2009 mund të shprehet edhe përmes rritjes së kredive dhe depozitave. Në shtator 2009, vlera totale e kredive arriti në 1.27 miliard euro (rreth 33.7 përqind e PBB-së për vitin 2009 apo një rritje prej 13.2 përqind). Megjithatë, norma e rritjes së kredisë në shtator 2009 ishte më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur norma vjetore e rritjes ishte 37.0 përqind, gjë që kryesisht reflekton rrethanat e reja të krijuara në ekonominë vendore si pasojë e ndikimit të krizës globale. Në këtë kontekst, bankat aplikuan politika më konservative të kreditimit, sidomos për kreditë e bizneseve e më pak për ekonomitë familjare. Në shtator 2009 kreditë për biznese shënuan një normë vjetore të rritjes prej vetëm 9.4 përqind, krahasuar me rritjen prej 35.9 përqind vitin e kaluar. Në anën tjetër, norma vjetore e rritjes për kreditë e ekonomive familjare ishte 25.6 përqind (40.7 përqind në shtator 2008). Sidoqoftë, shtrëngimi i kredidhënies ka të bëjë edhe me nevojën e bankave për të sforuar pozitën e tyre të likuiditetit, duke pasur parasysh normën më të ulët të rritjes së depozitave si burim kryesor i financimit të kredidhënies për bankat komerciale. Në anën tjetër, duke pasur parasysh rëndësinë e kredisë për biznesin në Kosovë, një shtrëngim më i theksuar mund të shkaktojë ngecje të mëtutjeshme në ekonomi gjë që mund të ndikojë në aftësinë paguese të kredimarrësve, me pasoja negative për vetë shëndetin e sektorit bankar.

Figura 7. Rritja vjetore e aseteve, kredive dhe depozitave

Niveli i depozitave shënoi një rritje vjetore prej 17.2 përqind duke arritur vlerën prej 1.646 miliard euro apo 43.3 përqind e PBB-së, rritje kjo po ashtu më e ngadalshme në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Zvogëlimi i disa burimeve të rëndësishme të financimit për ekonominë e Kosovës (për shembull, dërgesat e emigrantëve) kanë ndikuar negativisht nivelin e kursimeve në vend. Në këtë kontekst, performanca më e dobët e ekonomisë së vendit në përgjithësi ka zvogëluar potencialin për gjenerim të kursimeve duke rezultuar në një normë më të ulët të rritjes së depozitave në këtë periudhë. Duke pasur parasysh se kredidhënia në Kosovë në masën më të madhe financohet nga depozitat vendore, një ngadalësim i mëtejmë i rritjes së depozitave mund të shkaktojë shtrëngim të mëtejmë të kredidhënieς në vend. Sidoqoftë, gjatë kësaj periudhe depozitat kanë shënuar normë më të lartë të rritjes se sa kreditë. Ngritja e vazhdueshme e normave të interesit në depozita ka kontribuar pozitivisht në rritjen e depozitave të sektorit bankar. Sidoqoftë, një koordinim më i madh ndërinstitucional për zvogëlimin e informalitetit në ekonomi mund të zvogëlojë transaksionet në para të gatshme me efekte pozitive për rritjen e mëtutjeshme të depozitave në sektorin bankar. Kjo do të krijojë mundësi më të mëdha edhe për zgjerimin e kreditimit të ekonomisë.

5.2. Bilanci i Gjendjes i Sektorit Bankar

Struktura e aseteve të sektorit bankar deri në shtator 2009 nuk ka pësuar ndonjë ndryshim fundamental në krahasim më vitin paraprak. Kreditë vazhdojnë të përbëjnë pjesën më të madhe të aseteve me një pjesëmarrje prej rreth 62 përqind. Sidoqoftë, si pasojë e shtrëngimit të kredidhënieς, pjesëmarrja e kredive në shtator në 2009 ka qenë për 2pp më e ulët krahasuar me shtator 2008. Në përbërjen e aseteve të sektorit bankar pjesëmarrja e letrave me vlerë ka vazhduar të zvogëlohet dhe në shtator 2009 qëndroi në vetëm një përqind,

përderisa në shtator 2008 letrat me vlerë përfaqësonin 2.4 përqind të gjithsej aseteve. Zvogëlimi i investimeve në letra me vlerë në masë më të madhe filloj nga fillimi i vitit 2008 si rezultat i zhvendosjes së investimeve drejtë kreditimit të ekonomisë vendore të cilat ofrojnë normë më të lartë të kthimit, ndërsa rënia e tyre në periudhën e fundit i atribuohet edhe ecurive negative në tregjet financiare ndërkombëtare. Një rënie e lehtë (0.2pp) vërehet edhe në pjesëmarrjen e plasmaneve me bankat komerciale jashtë të cilat në shtator 2009 përfaqësonin 16.9 përqind të gjithsej aseteve.

Tabela 4. Struktura e aseteve, në përqindje


	shtator 2006	shtator 2007	shtator 2008	shtator 2009
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në	12.1	13.2	11.1	14.4
Bilanci me bankat komerciale	20.9	14.5	17.2	16.9
Letrat me vlerë	8.5	5.5	2.4	1.0
Kreditë dhe lizingu	54.9	62.2	64.6	61.9
Asetet fikse	2.0	1.9	2.0	1.9
Asetet tjera	1.6	2.8	2.7	3.9

Struktura e aseteve të sektorit bankar të Kosovës tregon për një ekspozim ndaj sektorit të jashtëm ekuivalent me 11 përqind të PBB-së. Struktura e aseteve të investuara jashtë vendit kryesisht përbëhet nga depozitat në banka komerciale dhe një pjesë më e vogël përbëhet nga investimet në letra me vlerë. Ndërsa, pjesa dërmuese e aseteve të sektorit bankar (89 përqind e gjithsej aseteve) është e eksposuar ndaj ekonomisë së Kosovës. Rrjedhimisht, sektori bankar i Kosovës ka pasur një ndjeshmëri më të ulët ndaj tronditjeve në sektorin e jashtëm finanziar dhe është treguar i mbrojtur nga efektet direkte të krizës globale.

Struktura e kredive të lëshuara nga bankat komerciale vazhdon të dominohet nga kreditë për ndërmarrjet. Këto kredi në shtator 2009 arritën vlerën 949.3 milion euro apo 74.2 përqind të gjithsej kredive të sektorit bankar. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar pjesëmarrja e këtyre kredive ka shënuar një rënie prej 2pp që reflekton rritjen më të ulët të këtyre kredive në krahasim me kreditë për ekonomitë familjare. Në shtator 2009, pjesëmarrja e kredive të ekonomive familjare arriti në 25.8 përqind (nga 23.2 përqind në shtator 2008). Norma më e lartë e rritjes e kredive të ekonomive familjare deri në një masë reflekton nivelin më të ulët të rrezikut që ndërlidhet më këto kredi. Po ashtu, normat e interesit për këto kredi kanë shënuar rënie më të theksuar, ndërsa në treg vazhdimesh janë paraqitur produkte të reja kreditore. Në këtë kontekst, vlen të theksohet zhvillimi i vazhdueshëm i tregut të kredive hipotekare që paraqet një produkt relativisht të ri në tregun bankar në Kosovë. Duke analizuar strukturën e kredive të reja të lëshuara nga sektori bankar për ekonomitë familjare gjatë periudhës janar–shtator 2009, vërehet se kreditë hipotekare kanë rritur pjesëmarrjen

në 21.9 përqind të gjithsej kredive të ekonomive familjare krahasuar me 13.7 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2008. Ndërsa, pjesa më e madhe e kredive të ekonomive familjare (78.1 përqind) vazhdon të përbëhet prej kredive konsumuese.

Figura 8. Struktura e kredive të ndërmarrjeve




Në ndarjen sektoriale te kreditimit për ndërmarrjet dominojnë kreditë për sektorin e shërbimeve të cilat në shtator 2009 arritën vlerën 688.4 milion euro apo 72.5 përqind të gjithsej kredive të lëshuara për ndërmarrjet (76.4 përqind në shtator 2008). Në këtë kuadër, pjesa më e madhe i është dedikuar ndërmarrjeve tregtare, kreditë e të cilave arritën vlerën 498 milion euro në shtator 2009, ndërsa pjesa tjetër prej 148.7 milion i është lëshuar ndërmarrjeve që ofrojnë 'shërbime tjera'. Dominimi i kredive për ndërmarrjet tregtare në strukturën e kredive të sektorit bankar reflekton strukturën e përgjithshme të ekonomisë së Kosovës, e cila kryesisht bazohet në importimin e mallrave nga jashtë, për deri sa prodhimi vendor vazhdon të mbetet në nivele të ulëta. Nëse analizohet ndryshimi vjetor i kredive për sektorin e shërbimeve, vërehet një rritje vjetore prej vetëm 3.9 përqind e cila është dukshëm më e ulët krahasuar me vitin e kaluar kur norma vjetore e rritjes kishte arritur në 36.2 përqind. Kjo bënë që sektori i shërbimeve të jetë sektori me ngadalësimin më të theksuar të kreditimit. Ngadalësimi i kredive për sektorin e shërbimeve në masë të konsiderueshme është rrjedhojë e zvogëlimit prej 9.6 përqind të kredive për ndërmarrjet që ofrojnë 'shërbime tjera'. Zvogëlimi i këtyre kredive reflekton shtrëngimin e përgjithshëm të kredi dhënies dhe pjesërisht disa ndryshime metodologjike në raportimin sektorial të kredive.

Norma më e lartë e rritjes u shënuar në kreditë e lëshuara për sektorin e industrisë, energjisë dhe ndërtimtarisë, vlera e të cilave shënoi një rritje vjetore prej 32 përqind, duke e ngritur pjesëmarrjen e këtyre

kredive në 23.2 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet (19.3 përqind në shtator 2008). Rritja e këtyre kredive njëherësh paraqet kontribuuesin kryesor në rritjen e nivelit të përgjithshëm të kredive për ndërmarrjet. Në kuadër të kredive për sektorin e industrisë, energjisë dhe ndërtimtarisë, pjesa më e madhe e kredive i është lëshuar industrisë prodhuese (51.7 përqind e totalit të këtyre kredive), ndërsa një rritje të konsiderueshme të pjesëmarrjes kanë shënuar kreditë për sektorin e minierave, të cilat në shtator 2009 arritën vlerën 16.2 milion euro (7.3 përqind të gjithsej këtyre kredive) nga 0.6 milion euro në shtator 2008.

Sektori që absorbon pjesën më të vogël të kredive të lëshuara nga sistemi bankar vazhdon të jetë sektori i bujqësisë me një pjesëmarrje prej 4.3 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrjet. Vlera e kredive të lëshuara për sektorin e bujqësisë në shtator 2009 arriti në 40.4 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.4 përqind. Edhe në kreditë për këtë sektor vërehet ngadalësim krahasuar me vitin e kaluar kur norma vjetore e rritjes kishte arritur në 41.3 përqind. Niveli i ulët i kreditimit për sektorin e bujqësisë mund t'i atribuohet normave më të larta të interesit për kreditë e këtij sektori që deri në një masë e kufizojnë kërkësen për kredi, si dhe kritereve më konservative të bankave për kreditë e sektorit të bujqësisë duke pasur parasysh një numër të specifikave që e karakterizojnë këtë sektor në Kosovë. Në këtë kontekst, paqartësitë mbi të drejtat pronësore paraqesin një problem të vazhdueshëm duke ndikuar kështu në ngritjen e nivelit të rrezikut kreditor të perceptuar nga bankat. Për më tepër, pjesa më e madhe e fermave bujqësore në Kosovë nuk janë të organizuara në formë të bizneseve dhe kanë mungesë të llogari-mbajtjes. Në këtë aspekt, nevojitet avancim i kapaciteteve planifikuese të kredi marrëseve potencial nga sektori i bujqësisë për të ngritur arsyeshmërinë ekonomike të projekteve të tyre investuese.

Struktura e kredive të sektorit bankar sipas afatit të maturimit ka vazhduar të jetë e ngjashme me periudhat paraprake. Pjesa më e madhe e kredive vazhdon të përfaqësohet nga kreditë me afat maturimi më të gjatë se dy vite, të cilat në shtator 2009 përbën 68.3 përqind të gjithsej kredive (68.0 përqind në shtator 2008). Kategoria e dytë për nga madhësia janë kreditë me afat maturimi deri në një vit të cilat në shtator 2009 përfaqësuan 20.6 përqind të gjithsej kredive, ndërsa kreditë me afat maturimi më të gjatë se një vit dhe më të shkurtër se dy vite përfaqësuan 11.1 përqind të gjithsej kredive. Sidoqoftë, në strukturën e kredive të reja të cilat janë lëshuar në periudhën janar-shtator 2009 vërehet një zvogëlim i pjesëmarrjes së kredive me afat më të gjatë maturimi çka pasqyron rritjen e kujdesit të sektorit bankar për shkak të krizës.


Figura 9. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit

Sa i përket strukturës së detyrimeve të sektorit bankar, në periudhën raportuese nuk ka pasur ndonjë ndryshim substancial në krahasim me periudhat paraprake. Depozitat vazhdojnë të përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimeve të sektorit bankar me pjesëmarrje prej 79.7 përqind të gjithsej detyrimeve (apo 1.646 milion euro). Kategoria e dytë për nga madhësia është kapitali vetanak i bankave që përfaqëson 9.2 përqind të gjithsej detyrimeve. Kjo kategori ka shënuar një rritje vjetore prej 5.7 përqind, ku kontribuues kryesor ishte kapitali aksionar që në shtator 2009 arriti në 154.9 milionë euro nga 131.9 milionë euro në shtator 2008. Në kuadër të strukturës së detyrimeve të sektorit bankar mund të veçojmë rritjen e borxhit të ndërvarur nga 7 milionë euro sa ishte në shtator 2008 në 24 milionë në shtator 2009. Ky zhvillim tregon se bankat komerciale kanë rritur kërkësën për financim nga jashtë si pasojë e rënies së normës së interesit në tregjet e jashtme financiare, por edhe si rezultat i ngadalësimit të rritjes së depozitave në vend. Megjithatë, burimi kryesor i financimit të aseteve të sektorit bankar mbeten depozitat në vend, prandaj ekspozimi ndaj kostos dhe ofertës së kapitalit në tregjet e jashtme është i ulët. Si rezultat, evoluimi i krizës financiare në sektorin e jashtëm dhe shtrëngimi i kushteve të financimit që pasoi me këtë rast nuk u reflektuan në mënyrë të drejtpërdrejtë në burimet e financimit të sektorit bankar të Kosovës.

Tabela 5. Struktura e detyrimeve, në përqindje

	shtator 2006	shtator 2007	shtator 2008	shtatot 2009
Bilanci nga bankat tjera	2.6	1.8	1.8	2.5
Depozitat	79.7	79.5	80.3	79.7
Detyrimet tjera	8.3	7.9	6.9	7.2
Borxhi i ndërvarur	0.6	0.5	0.4	1.2
Mjetet vetanake	8.8	10.3	10.6	9.5

Struktura e depozitave në sektorin bankar të Kosovës vazhdon të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare të cilat përbëjnë 58.8 përqind të gjithsej depozitave, të pasuara nga depozitat e ndërmarrjeve me 32.2 përqind dhe depozitat nga burimet tjera me 10 përqind. Depozitat e ndërmarrjeve shënuan një normë vjetore të rritjes prej 17.6 përqind, rritje kjo më e lartë se norma e rritjes së depozitave të ekonomive familjare prej 13.7 përqind. Në kuadër të depozitave të ndërmarrjeve vazhdojnë të dominojnë depozitat e ndërmarrjeve publike qe kapin vlerën prej 296.6 milion euro, ndërsa vlera e depozitave të ndërmarrjeve private është 233.3 milionë euro. Me transferimin e dividentës së Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK) në vlerë prej rreth 200 milion euro te Qeveria e Kosovës, do të shkaktohet një rënie e konsiderueshme e depozitave të ndërmarrjeve publike. Megjithatë, këto depozita do të vazhdojnë të qëndrojnë në bankat komerciale sipas afatit original të maturimit, por në kuadër të llogarisë së Qeverisë së Kosovës. Depozitat e jorezidentëve në sistemin bankar të Kosovës kanë shënuar rritje të vazhdueshme duke arritur vlerën prej 57.5 milion euro në shtator 2009, që paraqet një rritje vjetore prej 62 përqind. Kjo rritje deri në një masë mund të jetë rezultat i rritjes së normave të interesit për depozita në bankat komerciale që operojnë në Kosovë, por edhe si rezultat i rritjes së vazhdueshme të besimit të publikut në sektorin bankar të Kosovës.

Figura 10. Struktura e depozitave sipas sektorëve.

Struktura e depozitave ka mbetur e ngjashme me periudhat paraprake edhe sa i përket afatit të maturimit. Pjesa më e madhe e depozitave përbehet nga depozitat e kursimeve dhe të afatizuara që përbëjnë 70 përqind të totalit dhe pjesa tjeter përbëhet nga depozitat e trasferueshme të cilat përfaqësohen me 30 përqind. Në kuadër të depozitave të kursimit dhe të afatizuara, pjesa më e madhe përfaqësohet nga depozitat me afat maturimi deri në një vit, të cilat përbëjnë 88.2 përqind të këtyre depozitave. Ndërsa, 6.1 përqind e këtyre depozitave kanë afat maturimi prej më shumë se një vit dhe 5.7 e tyre kanë afat maturimi prej më shumë se dy vite. Një pjesëmarrje më e madhe e depozitave me afat më të gjatë maturimi do t'i kontribuojë përforcimit të mëtejmë të pozitës së likuiditetit në banat komerciale dhe gjithashtu do të sigurojë kushte përnjë kreditim më të qëndrueshmë dhe më afatgjatë të ekonomisë.

Struktura e depozitave në sektorin bankar paraqet një ekspozim minimal të këtyre depozitave ndaj rrezikut të normës së këmbimit. Rreth 93 përqind të gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës mbahet në valutën euro, ndërsa depozitat në valuta tjera në shtator 2009 përbën 6.1 përqind të gjithsej depozitave të sektorit bankar (5.8 përqind në shtator 2008).

5.3. Performance e sektorit bankar

Zvogëlimi i aktivitetit ndërmjetësues të sektorit bankar është reflektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në profitin e realizuar nga bankat komerciale. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, neto profiti i sektorit bankar, në shtator 2009, regjistroi një rënje prej 37.7 përqind, duke shënuar vlerën 18.3 milion euro. Rënia e profitit ishte pasojë e ngadalësimit të rritjes në nivelin e të hyrave të bankave komerciale. Deri në

shtator 2009, niveli i përgjithshëm i të hyrave të sistemit bankar shënoi një rritje vjetore prej 9.6 përqind krahasuar me rritjen vjetore prej 33.7 përqind të regjistruar deri në shtator 2008. Në anën tjetër, niveli i përgjithshëm i shpenzimeve reagoi në masë më të vogël ndaj ngadalësimit të aktivitetit ndërmjetësues, duke regjistruar kështu një rritje vjetore prej 29.4 përqind krahasuar me normën vjetore të rritjes prej 35.2 përqind në shtator 2008. Zvogëlimi i profitit paraqet kontribuuesin kryesor të zvogëlimit të profitabilitetit të sektorit bankar që, shprehur përmes treguesit të Kthimit Mesatar në Kapital (KMK) për vitin 2009 (i përvitësuar), u përgjysmua krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke shënuar nivelin prej 13.2 përqind (Kutia 1).


Kutia 1. Zbërthimi i faktorëve që ndikojnë në Kthimin Mesatar në Kapital

Kthimi Mesatar në Kapital (KMK) për sektorin bankar paraqet një tregues të rëndësishëm të profitabilitetit që shpreh raportin ndërmjet fitimit para tatimit dhe vlerës kontabël të kapitalit. Përveç profitit, ekzistonjë edhe faktorë të tjera të cilët e ndikojnë KMK-në e sektorit bankar. Për të kuptuar më saktë burimin e ndryshimeve të KMK-së, ky tregues mund të zbërthehet përfshirë pasqyruar produktin e katër faktorëve si në formulë³:

$$KMK = \underbrace{\left(\frac{\text{Profiti para tatimit}}{\text{Profiti Operacional}} \right)}_{\text{Margjina e profitit para tatimit}} \times \underbrace{\left(\frac{\text{Profiti Operacional}}{\text{Asetet e Peshuara me Rezik}} \right)}_{\text{Profiti i përshtatur ndaj riskut}} \times \underbrace{\left(\frac{\text{Asetet e Peshuara me Rezik}}{\text{Totali i Aseteve}} \right)}_{\text{Niveli i riskut}} \times \underbrace{\left(\frac{\text{Totali i Aseteve}}{\text{Kapitali}} \right)}_{\text{Shkalla e levës}}$$

Rritja e KMK-së si rezultat i rritjes së *marginës së profitit para tatimit* nënkuption se të hyrat janë rritur më tepër se shpenzimet dhe efekti për qëndrueshmërinë e sistemit bankar është pozitiv. Efekti për qëndrueshmërinë e sistemit bankar po ashtu është pozitiv nëse KMK-ja rritet si rezultat i rritjes së *profitit të përshtatur ndaj rrezikut*. Në anën tjetër, rritja e KMK-së si rrjedhojë e rritjes së *nivelit të rrezikut* ose *shkallës së levës* konsiderohet të ketë efekt negativ për qëndrueshmërinë e sektorit bankar, pasi që kjo nënkuption se bankat po ndërmarrin nivel më të lartë të rrezikut me qëllim të realizimit të profitit.

³ Zbërthimi i KMK-së është përdorur më herët nga Banka e Anglisë (Financial Stability Report, 2003), Banka e Suedise (Financial Stability Report, 2006) si dhe Banka e Slovenisë (Financial Stability Report, 2008).

Figura11. Faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e KMK-së

Duke pasur parasysh faktin se në shtator 2009 është regjistruar rënje e KMK-së, në Figurën 11 janë paraqitur faktorët që kanë ndikuar në këtë tregues sipas shkallës së kontributit në ndryshimin e saj. Siç mund të vërehet, zvogëlimi i marzhës së fitimit të sektorit bankar paraqet faktorin që ka ndikuar më së shumti në rënien e KMK-së, duke nënkuptuar se shpenzimet e sektorit bankar janë rritur me tepër se sa të hyrat. Po ashtu, efekt negativ në profitabilitetin e sektorit bankar vërehet se ka pasur edhe rënia e nivelit të riskut, që kryesisht pasqyron shtrëngimin e kredidhënies nga sektori bankar. Sidoqoftë, kjo ka implikime pozitive për nivelin e qëndrueshmërisë së sektorit. Në anën tjetër, efekt pozitiv në KMK shihet që ka pasur rritja e shkallës së levës që pasqyron rritjen më të shpejtë të aseteve se sa të kapitalit të sektorit bankar.

Ngadalësimi i normës së rritjes së të hyrave të sektorit bankar kryesisht i atribuohet ngadalësimit në të hyrat nga interesi dhe para se gjithash normës më të ulët të rritjes në të hyrat nga interesi në kredi. Po ashtu, rënia e normës së EURIBOR-it në tregun evropian shkaktoi zvogëlimin e të hyrave nga plasmanet jashtë vendit. Ngadalësim i rritjes u vërejt edhe në burimet tjera të të hyrave të sektorit bankar siç janë të hyrat nga komisionet. Të hyrat e sektorit bankar vazhdojnë të mbështeten në masën më të madhe në të hyrat nga interesi në kredi të cilat në shtator 2009 përfaqësuan 75.3 përqind të gjithsej të hyrave. Mbështetja e lartë në këto të hyra reflekton strukturën e aseteve të sektorit bankar të Kosovës ku kreditë përbëjnë pjesën më të madhe. Në anën tjetër, varësia e lartë në interesin nga kreditë bënë që niveli i përgjithshëm i të hyrave të ketë ndjeshshmëri të lartë ndaj një shtrëngimi më të theksuar të kredisë me implikime negative për profitin.

Tabela 6. Bilanci i Suksesit, në milionë euro

	shtator 2006	shtator 2007	shtator 2008	shtator 2009
Të hyrat	83.0	107.0	142.0	156.0
Të hyrat nga interesë	65.0	84.0	113.0	122.0
Të hyrat nga jointeresi	18.0	23.0	29.0	34.0
Shpenzimet	64.0	77.0	104.0	135.0
Shpenzimet e interesit	14.0	19.0	27.0	39.0
Shpenzimet tjera përvëç interesit	12.0	15.0	17.0	26.0
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	38.0	43.0	60.0	70.0
Të hyrat neto				
Të hyrat operuese neto	20.0	30.0	38.0	21.0
Të hyrat neto para tatimit	20.0	30.0	38.0	21.0
Provizonet për tatim	4.0	6.0	9.0	3.0
Neto fitimi/humbja brenda periudhës	16.0	25.0	29.0	18.0

Ngjashëm me periudhat e kaluara, shpenzimet për interes kanë vazhduar trendin e rritjes si rezultat i rritjes së depozitave si dhe rritjes së normave të interesit në depozita. Në shtator 2009, shpenzimet e interesit ishin për 45.9 përqind më të larta se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa pjesëmarrja e tyre në gjithsej shpenzimet e sektorit bankar arriti në 28.8 përqind (nga 25.6 përqind sa ishte në shtator 2008). Rritje u shënua po ashtu në shpenzimet për jo interes të cilat në shtator 2009 shënuan një rritje vjetore prej 48.5 përqind, duke rritur pjesëmarrjen e tyre në gjithsej shpenzimet në 19.3 përqind (16.8 përqind në shtator 2009). Rritja e shpenzimeve tjera përvëç interesit i atribuohet provisionimit të humbjeve në kredi të cilat, në shtator 2009, shënuan një rritje vjetore prej 47.1 përqind si rezultat i rritjes së kredive me probleme gjatë kësaj periudhe. Kategoria më e madhe në kuadër të shpenzimeve të sektorit bankar vazhdojnë të janë shpenzimet e përgjithshme dhe administrative të cilat në shtator 2009 përfaqësuan 51.9 përqind të gjithsej shpenzimeve. Si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe, kjo kategori e shpenzimeve ndoqi një trend më të ngadalshëm të rritjes duke e zvogëluar kështu pjesëmarrjen në gjithsej shpenzimet për 5.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Si kategoria më e rëndësishme e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative janë shpenzimet për personel të cilat përbëjnë 39.2 përqind të këtyre shpenzimeve. Deri në shtator 2009, shpenzimet e sektorit bankar për personel shënuan një rritje vjetore prej 15.8 përqind duke regjistruar vlerën prej 27.4 milion euro.

Zvogëlimi i profitit të sektorit bankar paraqet implikime negative për nivelin e efikasitetit në këtë sektor. Në këtë kontekst, kthimi mesatar në asetet e sektorit bankar për vitin 2009 (i përvitësuar) u zvogëlua

në 1.3 përqind (nga 2.6 përqind në vitin 2008) që mund të interpretohet si efikasitet më i ulët i sistemit bankar gjatë kësaj periudhe për të realizuar profit nga shfrytëzimi i aseteve të disponueshme. Rënia e efikasitetit mund të vërehet edhe nga rritja e raportit ndërmjet shpenzimeve të përgjithshme e administrative (shpenzimeve operacionale) dhe të hyrave të sektorit bankar që në shtator 2009 arriti në 44.8 përqind (42.1 përqind në shtator 2008). Megjithatë, numri i kredive për një punëtor të sektorit bankar shënoi normë pozitive të rritjes, që mund të interpretohet si rritje e efikasitetit. Sidoqoftë, kjo normë e rritjes ishte dukshëm më e ulët krahasuar me periudhat e kaluara. Në anën tjetër, vlera e kredive me probleme për një punëtor ka shënuar rritje duke sugjeruar kështu një efikasitetit më të ulët të sektorit bankar në menaxhimin e rrezikut kreditor.


Tabela 7. Treguesit e efikasitetit të sektorit bankar

	shtator 2006	shtator 2007	shtator 2008	shtator 2009
Asetet/ nr. i punëtorëve (mijëra euro)	47.9	49.5	51.0	56.4
Vlera e e KJP-ve; nr. i punëtorëve (mijëra euro)	9.2	13.5	11.2	14.4
Numri i kredive/ numri i punëtorëve	44.1	51.2	67.7	70.1

Si rezultat i ngushtimit të vazhdueshëm të dallimit ndërmjet normave të interesit në kredi dhe atyre në depozita, margjina neto e interesit në sektorin bankar të Kosovës po ashtu ka ndjekur trend rënës. Margjina neto e interesit në sektorin bankar paraqet dallimin ndërmjet të hyrave nga interesi dhe shpenzimeve për interes në raport me asetet e sektorit bankar. Në shtator 2009, ky tregues u zvogëlua në 6.3 përqind, që paraqet nivelin më të ulët që nga viti 2006. Normal e interesit në kreditë e lëshuara nga sistemi bankar kanë ndjekur një normë të vazhdueshëm të rënies, përderisa normal e interesit në depozita janë rritur vazhdimesht duke nënkuptuar kushte më të volitshme të ndërmjetësimit financiar (Kutia 2). Kjo deri në një masë reflekton rritjen e konkurrencës në sektorit bankar.

Kutia 2. Normal e Interesit

Dallimi ndërmjet normave të interesit në kredi dhe depozita në sektorin bankar të Kosovës ka treguar një trend të vazhdueshëm të rënies. Kjo si rezultat i zvogëlimit të vazhdueshëm të normave të interesit në kredi, përderisa normal e interesit në depozita treguan një trend të vazhdueshëm të rritjes. Ngushtimi i dallimit ndërmjet normave të interesit deri në një masë mund t'i atribuohet rënies së vazhdueshme të shkallës së koncentrimit në sistemin bankar, gjë që mund të sugjerojë se konkurenca në sistemin bankar të Kosovës po shënon rritje.

Figura 12. Normat e interesit

Normat e interesit në kredi nga viti 2006 kanë shënuar rënje të vazhdueshme, mirëpo për shkak të ndryshimeve metodologjike që nga viti 2008 (Figura 12), kjo rënje është bërë më pak e dallueshme. Deri në vitin 2008, shpenzimet administrative të cilat paguhën nga kredimarrësit nuk përfshiheshin në normën e interesit. Që nga viti 2008, këto shpenzime që mesatarisht paraqesin 1.5pp të normës së interesit, kanë filluar të përfshihen në normat e interesit për kreditë sipas standardeve statistikore ndërkombëtare. Nëse përfshirja e këtyre shpenzimeve do të bëhej edhe për periudhat para vitit 2008, normat e interesit për këto periudha do të kishin nivele më të larta gjë që do të bënte më evidente rënien e normave të interesit në vitet e fundit.

Në shtator 2009, normat e interesit në kredi (mesatarja lëvizëse 12 mujore) u zvogëluan në 14.2 përqind nga 15.1 përqind në shtator 2008. Kreditë për ndërmarrjet vazhdojnë të kenë norma më të larta të interesit se sa kreditë për ekonomitë familjare, gjë që reflekton profilin e rrezikut. Perceptimi i bankave mbi rrezikun kreditor është më i lartë për kreditë e ndërmarrjeve për shkak të ndjeshmërisë më të lartë që kanë ndërmarrjet ndaj lëvizjeve në ekonominë e vendit. Në shtator 2009, norma mesatare e interesit për kreditë e lëshuara ndërmarrjeve ishte 15.3 përqind krahasuar me 16.1 përqind në shtator 2008. Ndërsa, norma mesatare e interesit për kreditë e ekonomive familjare në këtë periudhë ishte 12 përqind, që paraqet një rënje vjetore prej 2pp. Megjithatë, normat e interesit për kreditë e ekonomive familjare dallojnë varësisht nga qëllimi i shfrytëzimit të kredive. Kreditë e destinuara për konsum kanë një normë më të lartë të interesit, gjegjësisht 13.2 përqind në shtator 2009, ndërsa norma mesatare e interesit për kreditë hipotekare është rrëth 10.8 përqind.


Me gjithë zhvillimet pozitive, normat e interesit për kreditë mund të shënojnë rënje të mëtutjeshme. Kjo mund të arrihet me një rritje të mëtejme të efikasitetit nga bankat komerciale. Megjithatë, rol i rëndësishëm në këtë aspekt i takon edhe përmirësimi të kushteve të tregut ku operojnë bankat komerciale. Në këtë kontekst, rritja e efikasitetit të gjykatave për të trajtuar lëndët e sektorit bankar do të lehtësonë ekzekutimin e kolateralit për kreditë e humbura, gjë që do të kontribuonte në zvogëlimin nivelit të rrezikut kreditor të perceptuar nga bankat. Po ashtu, rëndësi të madhe ka zbatimi i mirëfilltë i ligjit mbi raportimin financiar që do të pajiste bankat me informata më të besueshme mbi performancën e ndërmarrjeve që aplikojnë kredi. Për më tepër, nevojitet avancim i vazhdueshëm i kapaciteteve planifikuese nga ndërmarrjet në mënyrë që kërkesat për kredi të kenë arsyeshmëri më të lartë ekonomike. Zvogëlimin e mëtejjmë të normave të interesit në kredi, deri në një masë, e ka penguar edhe rritja e vazhdueshme e normave të interesit

në depozita që ka shkaktuar ngritjen e kostos së financimit për bankat. Norma mesatare e interesit në depozita në shtator 2009 ishte 4.4 përqind krahasuar me 4.0 përqind në shtator 2008. Megjithatë, për shuma më të larta se 250,000 euro, norma mesatare e interesit në depozita gjatë kësaj periudhe ka arritur në 5 përqind, duke ndikuar kështu në rritjen e normës mesatare të interesit për shkak të peshës së madhe që kanë këto depozita.


Treguesit e sektorit bankar sugjerojnë se sistemi bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të lartë të qëndrueshmërisë. Një prej treguesve të rëndësishëm që determinon kapacitet e bankës për kryerjen e detyrimeve dhe mbulimin e rezikut të kredive është Treguesi i Mjaftushmërisë së Kapitait (TMK) që paraqet raportin ndërmjet kapitalit të bankave dhe aseteve të peshuara me rrezik. Në shtator 2009, në sistemin bankar të Kosovës ky tregues shënoi 17.6 përqind që paraqet një nivel më të lartë se sa niveli minimal prej 12 përqind i kërkuar nga Banka Qendrore. Është inkurajues fakti se të gjitha bankat të cilat operojnë në Kosovë janë mirë të kapitalizuara dhe pa ndonjë vështirësi arrijnë të kenë TMK-në mbi nivelin prej 12 përqind. Niveli prej aktual i TMK-së paraqet një rritje prej 0.4pp krahasuar me shtator 2008 që kryesisht është rezultat i rritjes së kapitalit të bankave. Në anën tjeter, rritje shënuan edhe asetet e peshuara me rrezik, por me një normë më të ulët të rritjes krahasuar me gjithsej asetet e sektorit bankar. Si rezultat, pjesëmarrja e aseteve të peshuara me rrezik në gjithsej asetet e sektorit bankar në shtator 2009 u zvogëlua në 67.4 përqind krahasuar me 70.3 përqind në shtator 2008.

Një tregues mjaftë i rëndeshim për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar është edhe cilësia e portofolit kreditor. Sektori bankar i Kosovës vazhdimisht është karakterizuar me një cilësi të mirë të portofolit kreditor, me një pjesëmarrje të kredive jo-performuese (KJP) në gjithsej kreditë prej mesatarisht 3.4 përqind për periudhën ndërmjet viteve 2006–2009.⁴ Sidoqoftë, ngadalësimi i aktivitetit të përgjithshëm ekonomik në Kosovë deri në një masë ka ndikuar cilësinë e kredive, duke rritur pjesëmarrjen KJP-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar në 4.2 përqind në shtator 2009. Sektori bankar i Kosovës dhe Banka Qendrore vazhdimisht kanë ndjekur një qasje konzervative për sa i përket mbulimit të KJP-ve me provizione për humbje nga kreditë. Me fjalë të tjera, kjo mund të pasqyrojë averzionin e bankave komerciale/bankës qendrore ndaj riskut. Në këtë kontekst, mbulimi i KJP-ve me provizione për humbje nga kreditë vazhdimisht ka qenë mbi 100 përqind, ndërsa në shtator 2009 shkalla e mbulueshmërisë ishte rrëth 140 përqind. Për më tepër, rezultatet e nxjerra nga analiza e skenarëve të ndryshëm në kuadër të modelit ‘stress-test’ sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës është në gjendje të përballojë edhe nivele më të larta të KJP-ve të supozuara në këtë analizë (Kutia 3).

⁴ Kredi në sektorin bankar të Kosovës klasifikohen në pesë kategori kryesore: standarde, vrojtuese, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Kreditë jo-performuese konsiderohen kreditë që klasifikohen si të dyshimta dhe të humbura.

Figura 13. Kreditë jo performuese dhe provisionet

Shikuar sipas klasifikimit të kredive, struktura e KJP-ve kryesisht përbëhet nga kreditë e klasifikuara si të humbura të cilat përfaqësojnë rreth 66 përqind të gjithsej KJP-ve. Shikuar strukturën e përgjithshme të kredive sipas cilësisë, vërehet se kemi të bëjmë me një strukturë të ngashme krahasuar me vitin e kaluar (Figura 14). Sidoqoftë vërehet një rënje e lehtë e pjesëmarrjes së kredive standarde dhe rritje e pjesëmarrjes së kredive të kategorive tjera.

Figura 14. Struktura e kredive sipas cilësisë

Shikuar sipas sektorëve, një shkallë më e lartë e KJP-ve vërehet te kreditë e bizneseve, përderisa kreditë e ekonomive familjare karakterizohen me një shkallë relativisht të ulët të KJP-ve.

Kutia 3. Rreziku kreditor

Në kuadër të **rrezikut kreditor** është testuar aftësia e sistemit bankar për të mbajtur TMK-në në apo mbi nivelin e kërkuar rregullativ prej 12% nën supozimet për devijimeve të mundshme në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht duke supozuar norma të ndryshme të rritjes së KJP-ve.


Rezultatet e këtij testi sugjerojnë se sektori bankar është i aftë të mbajë treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit mbi nivelin prej 12 përqind edhe në rast të rritjes së vlerës së KJP-ve për 30 përqind, 50 përqind, 100 përqind, dhe 150 përqind. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit zvogëlohet nën nivelin prej 12 përqind vetëm në rast të rritjes së vlerës së KJP-ve për 200 përqind. Në këtë skenar, niveli i TMK-së zvogëlohet në 11.4 përqind që është afër nivelit të kërkuar.

Një skenar tjetër që identifikon normën e KJP-ve që do të shkaktonte rënien e TMK-së nën nivelin e kërkuar, sugjeron se sistemi bankar është në gjendje të përballoj një ngritje të pjesëmarrjes së KJP-ve në gjithsej kreditë deri në 12.1 përqind duke e mbajtur TMK-në në 12 përqind. Këto rezultate tregojnë nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë së sektorit bankar duke konsideruar faktin se norma aktuale e KJP-ve është 4.2 përqind.

Gjithashtu, është konsideruar aftësia e sistemit bankar për të përballuar dështimin e kredimarrësve më të mëdhenj në secilën bankë, ku rezultatet po ashtu sugjerojnë gjendje të kënaqshme të qëndrueshmërisë së sistemit.

Nga të dhënat e shtatorit 2009 mund të observohet se bankat e Kosovës kanë shkallë të lartë të likuiditetit. Depozitat, si burim kryesor i likuiditetit të bankave, kanë vazhduar të rriten me nivel më të lartë se kreditë. Raporti kredi-depozita në shtator 2009 ishte 77.7 përqind që është më i ulët se sa niveli prej 80 përqind i rekomanduar nga Banka Qendrore. Po ashtu, ky raport ka shënuar rënien krasuar me vitin e kaluar kur raporti kredi-depozita ishte 80.5 përqind.

Figura 15. Treguesit e likuiditetit



Përforcimi pozitës së likuiditetit në sistemin bankar të Kosovës vërehet edhe nga pjesëmarrja e aseteve likuide në gjithsej asetet e sektorit bankar që në shtator 2009 ariti në 32.3 përqind ose 1.6 përqind më shumë se vitin e kaluar. Duke analizuar raportin ndërmjet aseteve likuide dhe detyrimeve afat shkurta vërehet se është shënuar një rritje modeste nga 43.1 përqind që ishte në vitin 2008 në 44.7 përqind në këtë vit. Rritja e likuiditetit të bankave komerciale, përveç ngadalësimit të rritjes ës kredisë, po ashtu mund të ketë qenë rezultat i anticipimit të tërheqjes së depozitave të PTK-së të cilat nga tetori 2009 janë transferuar te Qeveria e Kosovës në formë të dividentës. Tërheqja e këtyre depozitave mund të kufizojë kapacitetin e sektorit bankar për të zgjeruar kredi dhënien. Me gjithë turbulencat në sektorin e jashtëm financiar, të gjitha bankat që operojnë në Kosovë kanë gëzuar gjendje të kënaqshme të likuiditetit gjatë tërë periudhës së evoluimit të krizës globale, duke plotësuar pa vështirësi të gjitha detyrimet. Gjendja e kënaqshme e likuiditetit të sektorit bankar të Kosovës tregohet edhe përmes analizës së rezultateve të gjeneruara përmes modelit 'stress-test' ku bankat paraqiten në gjendje të kryejnë detyrimet e tyre edhe në rast të normave më të larta të tërheqjes së depozitave të cilat janë supozuar në skenarë të ndryshëm (Kutia 4).

Kutia 4. Rreziku i likuiditetit

Në kuadër të **rrezikut të likuiditetit** është testuar sensitiviteti i bankave ndaj tërheqjes së konsiderueshme të depozitave. Më konkretisht, është testuar mjaftueshmëria e mjeteve likuide në sistemin bankar për të përballuar norma të ndryshme të tërheqjes së depozitave.

Rezultatet tregojnë se sistemi bankar është në gjendje të përballoj një tërheqje të depozitave deri në 17.4% pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë, në rastin kur si mjete likuide në dispozicion (përpos mjeteve likuide bazë) konsiderohen edhe plasmanet dhe letrat me vlerë me maturitet deri në 7 ditë. Përderisa, në rastin kur si mjete likuide konsiderohen edhe plasmanet dhe letrat me vlerë me maturitet deri në 30 ditë, norma e përballueshme e tërheqjes së depozitave pa pasur nevojë për likuiditet shtesë arrinë në 28.2%.⁵ Gjendja e likuiditetit në sistemin bankar tregohet e kënaqshme edhe nën supozimin e tërheqjes së depozitave të tre depozitarëve më të mëdhenj në secilën bankë.

Sistemi bankar tregohet likuid edhe në rast të tërheqjes së depozitave të qeverisë, duke respektuar maturitetin e depozitave të saj në secilën prej bankave.⁶ Si mjete likuide në këtë skenar janë supozuar mjetet me afat maturitet të njëjtë me afatin e maturimit të depozitave të konsideruara për tërheqje. Depozitat e qeverisë përbëjnë 10.9 përqind të gjithsej depozitave të sistemit bankar.

6. Fondet Pensionale

Sistemi pensional i Kosovës vazhdon të operojë në bazë të një skeme moderne e bazuar në tri shtylla kryesore. Në këtë kuadër, shtylla e parë i referohet pensionit bazë që paguhet nga Qeveria e Kosovës për të gjithë personat mbi moshën 65 vjeçare. Shtylla e dytë menaxhohet nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) dhe përfshinë kontributet e obligueshme që paguhen nga punëmarrësit dhe punëdhënësit (5


⁵ Në kuadër të mjeteve likuide nuk janë konsideruar plasmanet dhe letrat me vlerë jashtë vendit me afat maturimi më të gjatë se 30 ditë dhe po ashtu nuk është konsideruar mundësia e shfrytëzimit të ndonjë linje kreditore si burim likuiditeti.

⁶ Struktura e depozitave në këtë skenar pasqyron gjendjen pas transferimit të dividendës së PTK-së te Qeveria e Kosovës në tetor 2009.


përqind secila palë). Shtylla e tretë përfaqëson skemat vullnetare të pensioneve, ku përveç TKPK-së, operon edhe Fondi Slloven-Kosovar i Pensioneve.

TKPK paraqet sektorin që është prekur në masën më të madhe nga kriza financiare globale. Kjo si rezultat i rënies së vlerës së aksioneve të TKPK-së në investimet e bëra jashtë vendit. Çmimi i njësisë së aksionit të KPST-së në muajin shkurt 2009 arriti nivelin minimal gjatë gjithë periudhës së funksionimit prej 0.796 euro. Zhvillimet në vlerën e investimeve të TKPK-së ishin në linjë me zhvillimet e përgjithshme në tregjet financiare globale. Kjo mund të observohet nga Figura 16, ku vërehet se vlera e aksioneve të TKPK-së ka ndjekur një trend shumë të përafërt me trendin e indeksit Dow Jones Industrial që është një tregues i rëndësishëm i performancës së tregjeve globale.

Figura 16. Çmimi i aksioneve të TKPK-së dhe indeksi Dow Jones Industrial



Rikuperimi i tregjeve botëre pas tremujorit të parë të vitit 2009 u reflektua në ngritjen e vlerës së aksioneve të TKPK-së duke arritur në 0.95 në shtator 2009. Zhvillimet pozitive pasuan edhe gjatë pjesës së mbetur të vitit 2009. Si rezultat i kësaj, investimet e TKPK-së shënuan normë pozitive të kthimit dhe në shtator 2009 arriti në 35.6 milion euro. Me gjithë faktin se TKPK përfaqësonte një ndër fondet pensionale me rënien më të madhe të vlerës së investimeve, në krahasim me fondet pensionale të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, me ngritjen e performancës së tregjeve, TKPK rradhitet ndër fondet pensionale me normën më të lartë të kthimit në investime (Figura 17).

Figura 17. Krahasi i performancës së TKPK-së me fondet pensionale nga disa vende te zgjedhura.

Pjesa më e madhe e investimeve të TKPK-së vazhdon të jetë në sektorin e jashtëm ndërsa pjesa e mbetur është e investuar në sektorin finansiar në Kosovë.


7. Kompanitë e sigurimeve

Në tregun e sigurimeve në Kosovë vazhdojnë të operojnë dhjetë kompani të sigurimeve, prej të cilave shtatë anë me kapital të huaj dhe tri me kapital vendor. Asetet e sektorit të sigurimeve kanë vazhduar të rriten duke arritur vlerën prej 80.1 milion euro në shtator 2009, që paraqet një rritje vjetore prej 7.3 përqind. Struktura e aseteve të këtij sektori dominohet nga depozitat të cilat përbëjnë 66.8 përqind të gjithsej aseteve. Struktura e detyrimeve dominohet nga kapitali aksionar vlera e të cilit në shtator 2009 shënoi një rritje vjetore prej 13.7 përqind, duke përfaqësuar 51 përqind të gjithsej detyrimeve. Një tjetër kategori e rëndësishme në strukturën e detyrimeve është rezerva teknike që përfaqëson 44.1 përqind të gjithsej detyrimeve. Vlera e rezervave teknike në shtator 2009 ishte për 10.3 përqind më e lartë se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Numri i polisave të shitura dhe vlera e primeve të pranuara nga kompanitë e sigurimeve po shënon rritje të vazhdueshme. Në shtator 2009, numri i polisave të shitura arriti në 404 mijë, një rritje vjetore prej 8.4 përqind. Ndërsa vlera e primeve të pranuara është rritur nga 44 milionë euro sa ishte në shtator të vitit 2008 në 53 milionë në shtator të vitit 2009 apo një rritje vjetore prej 20.6 përqind. Rritjes së vlerës së primeve të mbledhura i ka kontribuar edhe zhvillimi i produktit të sigurimit të jetës nga kompanitë e sigurimeve. Primet nga polisat e sigurimit të jetës u rritën nga 7 milionë euro sa ishin në vitin 2008 në rreth 15 milionë euro në vitin 2009. Pjesmarrja e primeve nga polisat e sigurimit të jetës në gjithsej primet e pranuara nga kompanitë e sigurimeve arriti në 28 përqind në shtator 2009 (nga 16 përqind në shtator 2008). Sidoqoftë, pjesa më e madhe

primeve vazhdon të përbëhet nga primet e gjeneruara prej policave për sigurimin e automjeteve, gjegjësisht Polisat për Përgjegjësi ndaj Palës së Tretë (PPT), të cilat përfaqësojnë 53 përqind të gjithsej primeve. Vlera e primeve të pranuara nga kjo kategori e investimeve shënoi një rënje vjetore prej 1.5 përqind në shtator 2009 duke shënuar vlerën prej 27.8 milion euro. Një tjetër burim i të hyrave për kompanitë e sigurimeve përbëhet nga policat kufitare të cilat deri në shtator 2009 gjeneruan prime në vlerë 10.4 milion euro (8.7 milion euro në shtator 2008).

Figura 18. Struktura e primeve të pranuara



Në shtator 2009, vlera e dëmeve të paguara ishte 12.8 milion euro që paraqet një rënje vjetore prej 1.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rënje kryesisht është rezultat i zvogëlimit të kompensimit të dëmeve për mbajtësit e polisave për sigurim të përgjegjësisë ndaj palës së tretë të cilat në shtator 2009 ishin për 12 përqind më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke shënuar vlerën prej 9.9 milion euro. Si rrjedhojë e kësaj, raporti ndërmjet gjithsej dëmeve të paguara dhe primeve të pranuara u zvogëlua në 24.3 përqind në shtator 2009 krahasuar me 29.6 përqind në shtator 2008.

8. Institucionet mikro-financiare

Institucionet mikro-financiare paraqesin një sektor të rëndësishëm të sektorit financiar të Kosovë po shënojnë rritje të vazhdueshme si për nga numri i institucioneve ashtu edhe për nga vlera e aseteve. Në shtator 2009, në sistemin finansiar të Kosovës operonin 19 institucione mikro-financiare krahasuar me 16 sa operonin në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Vlera e përgjithshme e aseteve të këtij sektori arrii në 133.7 milion euro, që paraqet një rritje vjetore prej 35 përqind. Kategoria kryesore e aseteve të këtyre institucioneve përbëhet nga kreditë, të cilat në shtator 2009 përbën 81.4 përqind të gjithsej aseteve. Në shtator 2009, vlera e këtyre

kredive arriti në 108.8 milion euro që paraqet një rritje vjetore prej 22 përqind. Kreditë e institucioneve mikrofinanciare kryesisht janë kredi të vogla, një pjesë e konsiderueshme e të cilave është e drejtuar në financimin e bujqësisë. Trendi i rritjes së kredive të institucioneve mikro-financiare ka vazhduar të jetë i ngjashëm me periudhat e kaluara. Si rezultat, pjesëmarrja e kredive të institucioneve mikro-financiare në gjithsej kreditë e sektorit finansiar në Kosovë u rrit në 7.9 përqind, nga 7.3 përqind në shtator 2008. Burimi kryesor i financimit të institucioneve mikro-financiare vazhdojnë të jenë linja kreditore të pranuara nga jashtë vendit të cilat në shtator 2009 kishin vlerën 79.4 milion euro apo 59.4 përqind e gjithsej detyrimeve.

9. Ndihmësit finansiar

Ndihmësit Finansiar në sektorin finansiar të Kosovës kryesisht përbëhen nga Byrotë e Këmbimit dhe Agjensionet për Transferimin e Parave (ATP). Deri në fund të shtator 2009, shuma e transfereve të dëguara përmes ATP-ve në Kosovë ishte 148 milion euro që paraqet një rënie vjetore prej 4.6 përqind. Kjo rënie deri në një masë reflekton edhe rënien e dërgesave të emigrantëve gjatë kësaj periudhe, një pjesë e të cilave dërgohen në Kosovë përmes këtij kanali të transferit të parave. Si pasojë e kësaj, në shtator 2009, pjesëmarrja e transfereve të dëguara përmes ATP-ve zbriti në 9.5 përqind të gjithsej transfereve që pranohen në Kosovë nga 10.3 përqind në shtator 2008. Pjesa më e madhe e transfereve që pranohen në Kosovë (80.5 përqind e të gjitha transfereve) vazhdon të dërgohet përmes sistemit bankar. Deri në shtator 2009 nga Kosova për në vendet tjera, përmes ATP-ve janë dërguar 15.3 milion euro, që është një rritje prej 8.8 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjithsej shuma e transfereve nga Kosova për në vendet tjera, deri në shtator 2009, ishte 2.2 miliard euro ku pjesa më e madhe është dërguar përmes sistemit bankar (82.7 përqind e totalit).

